

TOMORR PLANGARICA

STUDIMI I SINTAKSËS DIALEKTORE DHE KORPUSI I GJUHËS SË FOLUR SHQIPE

(*Një projekt¹ që bart / mund të bartë një synim edhe më të madh*)

Nisma e ndërmarrë nga studiuesit e departamenteve të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA) për shqyrtimin e variacionit sintaksor në të folmet e shqipes dhe përgatitjen e Atlasit të Sintaksës Dialektore të Shqipes (nismë e ndërmarrë qysh në vitin 2016) synon ndriçimin e një problematike që lidhet me çështje që jo vetëm plotësojnë hapësira ende të pambuluara sa duhet në studimin e shqipes, por, sidomos, që nxisin e orientojnë studimet për të ardhmen. Organizimi në këtë kuadër i *tryezave të rrumbullakëta*, ku diskutohen çështje të ndryshme teorike e praktike që lidhen me këtë projekt, janë një mundësi më shumë që u krijohet studiuesve për të shprehur qëndrimet e pikëvështrimet e tyre për të përvijuar një pamje sa më të plotë të problematikës që synohet të jetë pjesë e angazhimeve të tyre në të ardhmen. Mëtimi i organizatorëve për të nxitur debatin përmes këtyre tubimeve shkencore është shenjë emancipimi shkencor. Nxitja e debatit shkencor në fazën që paraprin përvijimin e platformës për studimin e objektit veçse shton sigurinë për suksesin e hapave që do të hidhen më tej. Produkte të pritshme të debatit janë pikëvështrimet që priren t'i pasurojnë qasjet ndaj profileve të ndryshme të objektit, sidomos në periudhën e tanishme, kur kahet e shkollat e ndryshme të mendimit gjuhësor evropian e më gjerë sjellin prurje me vlerë në aspektin teorik e praktik, që mund të orientojnë më mirë punën dhe të ndihmojnë në disiplinimin e energjive të shpenzuara.

Shqyrtimi i variacionit sintaksor këta dhjetëvjeçarët e fundit ka zgjuar interes të veçantë për sintaksën dialektore, për veçantitë që shfaqin të folmet e ndryshme në gjuhë të ndryshme të Europës e më gjerë. Në dy-tre dhjetëvjeçarët e fundit janë të shumta projektet që i janë drejtuar kësaj problematike (më se 15 projekte që janë në zhvillim e sipër, të cilat ndjekin punën e bërë në më se 11

¹ Bëhet fjalë për projektin *Variacioni sintaksor në të folmet e shqipes: tipare dhe treva*, të ndërmarrë nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë” (2016). Në fjalën e mbajtur në *Tryezën e rrumbullakët*, më 13 dhjetor 2017 janë parashtruar argumentet në vijim që mund të nxisin zgjerimin e synimeve të këtij projekti drejt punës për krijimin e *Korpusit të gjuhës shqipe të folur*.

projekte të tjera të realizuara në fillim të viteve 2000)². Po ashtu, veçantitë e të folmeve në gjuhë të veçanta (në kuadër të së ashtuquajturës “sintaksë dialektore” ose “mikrovariacioni sintaksor”) kanë përthithur përkujdesjen e gjuhëtarëve, për shembull, projekti “Mikrovariacioni sintaksor në gjuhët romane të Francës” (SYMILA-Syntactic Microvariation in the Romance Languages of France)³, “Atlasi sintaksor i dialekteve holandeze” (SAND – The Syntactic Atlas of the Dutch Dialects)⁴, “Korpusi gojor dhe sonor i spanjishtes rurale” (COSER – Corpus oral y sonoro del español rural)⁵ etj., etj. Po mënjanohet në këtë mënyrë mosinteresimi i vërejtur për shumë kohë i dialektologëve për sintaksën dhe indiferenca e sintaksologëve për dialektet, si një tjetër mundësi për krahasimin e të dhënave gjuhësore në të folmet e përafërta dhe arritjen e përfundimeve teorike për gjuhën / ligjërimin dhe veçantitë e ngjizjes së saj / tij përtej universaleve, në gjuhë e treva të veçanta të përdorimit. Prurjet teorike kanë krijuar, pra, kontekstin e përshtatshëm që nxit interesime më të adresuara edhe në fushën e sintaksës dialektore.

Madje zhvillimet në fundin e shekullit XX e fillimin e shekullit XXI “synuan të nxjerrin në pah *parimet* – universale – të aftësisë ligjërimore dhe *parametrat* – e veçantë për çdo gjuhë – që përcaktojnë larminë gjuhësore. Me këtë qëllim, në fushën e dialektologjisë janë hapur fronte të reja shqyrtimi, që synojnë studimin e fushës së variacionit sintaksor dhe verifikimin e vlefshmërisë së modeleve dhe parimeve të propozuara”⁶. Për më tepër, studimet e kësaj natyre po dëshmojnë se “gramatika dialektore është burim informacioni i çmuar – dhe deri tani i nënvlerësuar – jo vetëm për karakterizimin e një fushe gjuhësore në veçanti, por edhe për studimin tipologjik të gjuhëve”⁷. Përftohet në këtë mënyrë një dobi e dyanshme në studimet gjuhësore. Nga njëra anë nxiten gjuhëtarët të njohin më thellë e të përshkruajnë më gjerë të dhënat empirike që ofrojnë sidomos realitetet e folura gjuhësore; nga ana tjetër, mundësohen përgjithësimet dhe zhvillohet mendimi teorik. M. Oliviéri thekson se “[...] qysh prej modelit *Government and Binding* të viteve 1980 deri në programin minimalist më të fundit, Çomski ka propozuar [...] një model që mundëson krahasimin në fushë të sintaksës. Ky model, “Parime e parametra”, parakupton që sintaksa është e organizuar sipas

² Shih më gjerë: *Project on dialect syntax* [në linjë]: www.dialectsyntax.org.

³ Shih më gjerë [në linjë]: SYMILA-<http://symila.univ-tlse2.fr>.

⁴ Shih Sjef Barbiers et al., *The Syntactic Atlas of the Dutch Dialects*, [në linjë]: link.springer.com, 10.1057/9780230223.

⁵ Shih Inés Fernandez-Ordóñez, *La Grammaire dialectale de l'espagnol à travers le corpus oral et sonore de l'espagnol rural*, në *Corpus*, 9/2010, f. 81-114.

⁶ Michèle Oliviéri, “Y a-t-il des frontières dialectales en syntaxe?”, *Revue Etudes corses*, 2004, f. 93. Gjithashtu, [në linjë]: hal.archives-ouvertes.fr.

⁷ Inés Fernandez-Ordóñez, art. i cit., f. 109.

parimeve që përvijohen prej gramatikës universale, të cilat janë në harmoni me *parametrat* që ndryshojnë prej një gjuhe në tjetrën, çka përcakton diversitetin gjuhësor. Në këtë mënyrë studimi i variacionit sintaksor bëhet i mundshëm në këtë kuadër teorik dhe në të vërtetë gjuhëtarët punojnë gjithnjë e më shumë në këtë drejtim [...]”⁸

Nga ana tjetër, zhvillimet në fushën e pragmatikës dhe teorive të të thënit, që u kushtojnë vëmendje të veçantë entiteve përtejfrazole, diskursit dhe tekstit, e në këtë mënyrë edhe kontekstit në përfitim të domethënies, mundësojnë shqyrtime për dukuritë e natyrës *makrosintaksore*. Zhvillimet në këto fusha po nxitin grumbullimin e dëshmimeve gjuhësore posaçërisht nga gjuha e folur dhe krijimin e korpuseve të gjuhës së folur. Ky material i begatë po shërben si bazë për shqyrtimet e sotme gjuhësore të natyrës teorike, por edhe rivështrimin e riinterpretimin e dukurive gramatikore, përkatësisht edhe të sintaksës dialektore ose mikrovariacionit sintaksor. Zhvillimi i teknologjive të reja për regjistrimin dhe përpunimin e të dhënave përmes programeve e softuerëve gjithnjë e më funksionalë për përpunimin e të dhënave kanë lehtësuar punën dhe rezultatet kanë qenë të prekshme. Claire Blanche-Benveniste, njohëse në zë e problematikës së gjuhës së folur, thekson: “Korpuset e mëdha të gjuhëve të folura janë zhvilluar shumë shpejt në vitet e fundit për të gjitha gjuhët e mëdha të Europës. [...] Dy universe kërkuesish i trajtojnë sot këto korpuse. Në njërin, informaticienët, të interesuar drejtpërdrejt për aspektet ekonomike, që përdorin shumë përllogaritje të probabilitetit për të analizuar të dhënat e gjuhës së folur dhe shqetësohen përgjithësisht pak për të përmirësuar paraqitjen e gramatikës. Nga ana tjetër, gramatikanët, të interesuar për rinovimin e disiplinës së tyre, që i shqyrtojnë sistematikisht këto korpuse, aq sa konceptimi i përgjithshëm i disiplinës së tyre është modifikuar tashmë thellësisht. Mjafton të konsultojmë *Gramatikën* e madhe të anglishtes së folur e të shkruar, të botuar më 1999 nën drejtimin e D. Biber-it, të *Longman*-i, për të parë nga afër pasojat: ajo është mjaft e ndryshme prej asaj çka ishin gramatikat para epokës së korpuseve. [...] Marrja parasysh e gjuhëve të folura në Europë është duke ndryshuar konceptimin që kemi për gramatikën e gjuhëve tona”⁹.

- *Përtej synimit të shprehur të projektit*

Duke e konsideruar me shumë vlerë nismën e ndërmarrë nga departamentet e Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike për shqyrtimin e variacionit sintaksor në gjuhën shqipe dhe hartimin e Atlasit të Sintaksës Dialektore të Shqipes, duke qenë të

⁸ M. Olivieri, art. i cit., f. 77.

⁹ Claire Blanche-Benveniste “Corpus de langue parlée et description grammaticale de la langue”, në *Langage et société*, 2007/3, n° 121-122, Editions de la Maison des sciences de l’homme, f. 139.

ndërgjegjshëm që problematika që ngërthehet në të ashtuquajturën *sintaksë dialektore*, e më gjerë akoma *sintaksë popullore*, që parakuptojnë larminë e strukturave në të folmet në treva të ndryshme, në përdorimin e përditshëm të gjuhës shqipe, por sidomos edhe në përdorimet mjeshtërore të gjuhës me funksion estetik (në përralla, rrëfime, etj.), duke qenë në një mendje me hartuesit e projektit që studimi i kësaj problematike nuk ka zënë *sa dhe si* duhet vend në shqyrtimet tona, po japim disa ide për ta zgjeruar disi synimin dhe objektin e këtij projekti, për ta konsideruar këtë nismë si pjesë të një projekti më të gjerë, që mund të synojë punën më të orientuar për krijimin e *korpusit të gjuhës së folur shqipe*.

Kemi, më së paku, dy shtysa të natyrës konceptuale e praktike që e motivojnë këtë zgjerim të nismës:

Së pari, shohim një lidhje të natyrshme mes punës që do të bëhet për studimin e sintaksës dialektore të shqipes, më saktësisht të të ashtuquajturit mikrovariacion sintaksor (pra shqyrtimit të karakteristikave a veçantive në kuadër të fjalisë) dhe synimeve për krijimin e korpusit të gjuhës së folur shqipe, i cili e parakupton dhe e përfshin edhe shqyrtimin e mikrovariacionit sintaksor, si një element përbërës të atij korpusi. Por, meqë shqyrtimet parakuptojnë një rrafsh sinkronik studimi dhe synohet të grumbullohen (regjistrohesh) dëshmi për gjendjen e sotme të asaj problematike në të folmet e shqipes, në treva të ndryshme, realiteti i folur gjuhësor, statusi i sotëm i folësve të shqipes do të ofrojë dëshmi gjuhësore që vetvetishëm do të nxjerrin në pah edhe veçanti të lidhura me një organizim a segmentim të dytë sintaksor (të rrafshit makrosintaksor), të cilat nuk kushtëzohen vetëm prej veçantive topolektale, por edhe sociolektale, diafazike etj. Dhe tërësia e të dhënave, duke bartur veçantitë topolektale të mikrovariacionit sintaksor, do të bartë njëherazi edhe veçantitë dhe statusin e gjuhës së folur shqipe. Në përvojat e ndryshme europiane kjo lidhje e ndërsjellë ka nxitur punën për krijimin e korpusit të gjuhës së folur, krahas asaj për studimin e sintaksës dialektore.

Për më tepër, duke synuar shqyrtimin e variacionit sintaksor në të folmet e shqipes dhe më tej përgatitjen e Atlasit të Sintaksës Dialektore të Shqipes nuk duhet të neglizhohet një tregues që ka të bëjë me vetë objektin e studimit: të flasësh për *variacionin sintaksor në të folmet e shqipes*, për *veçantitë sintaksore të të folmeve në treva të ndryshme*, do të thotë të përcaktosh një objekt studimi që në etapën e tanishme, me dëshmi gjuhësore e regjistrime të bëra rishtas, shfaqet me profile më të shumta. Studimi i këtij objekti me parimet, metodologjitë, konceptet e praktikat shqyrtuese vetëm të dialektologjisë e të mikrosintaksës do të ishte i pamjaftueshëm. Në etapën e tanishme, veçantitë gjuhësore / dialektore që lidhen me përkatësinë gjeografike të shfaqjes së tyre (pra, që mundësojnë të shfaqen si tregues të *variantit topolektal a diatopik të shqipes*) mund të mos gjenden më të ngulitura a të shprehura siç mund të ishin disa dhjetëvjeçarë më parë në shumicën e subjekteve, ngaqë folësit kanë një

raport të ndryshëm e më të ngushtë me *variantin e standardit*; nga ana tjetër, ata shfaqin një kompetencë më të spikatur ligjërimore në diskurs, si pasojë e zhvillimeve jashtëgjuhësore të sotme; në ligjërimin e tyre, krahas treguesve që kanë të bëjnë me mikrovariacionin sintaksor, do të spikatin edhe ato diskursivë, që lidhen me situatat komunikative, statusin e tyre në ligjërim, përshtatjen gjuhësore në varësi të tematikës, bashkëfolësit / bashkëfolësve etj. Ky nivel i kompetencës ligjërimore (e cila shfaqet tashmë si *situacionale, diskursive, semantike* a *semiolinguistike*, nëse do të shpreheshim me termat e Charaudeau-së¹⁰) i vë folësit kushtëzime të ndryshme në komunikim dhe i mundëson individit / grupeve të individëve të jenë më të suksesshëm në varësi të situatave të komunikimit, të fushës së veprimtarisë për të cilën bëhet fjalë apo formës gjuhësore të ligjërimin (pra, jo thjesht në lidhje me të folmen dialektore të origjinës). Ndaj në etapën e tanishme, shqyrtimi i veçantive makrosintaksore, por edhe i dukurive të tjera gramatikore e leksikore, mund të synojë *en bloc* gjuhën e folur, mbi bazën e korpusit të gjuhës së folur, për krijimin e të cilit kjo nismë e Institutit mund të shërbente si pikënisje; dhe mbi të dhënat e grumbulluara më parë, dhe ato të grumbulluara rishtazi në lidhje me përkatësinë gjeografike, sociale a llojin e ligjërimin (e po ashtu, temën, fushën e veprimtarisë etj.), të disiplinohen e shqyrtohen më tej dukuritë sipas kriterëve funksionale më të përshtatshme për çdo *variant* të shqipes së sotme, kupto në këtë rast edhe atë topolektal. Pra, puna për shqyrtimet e sintaksës dialektore, të mikrovariacionit sintaksor, integrohet natyrshëm në studimin e të dhënave të gjuhës së folur.

Së dyti, bindjen për të mos ngurruar për zgjerimin e synimeve të nismës së ndërmarrë na e përforcojnë edhe disa tregues të aspektit praktik, që marrin rëndësi të veçantë kur përpjekjet për realizimin e projektit zbesin në terrenin konkret të grumbullimit e regjistrimit të të dhënave. Duke i dhënë rëndësinë e duhur punës për grumbullimin e dëshmimeve gjuhësore a regjistrimin e tyre në treva të ndryshme të përdorimit, duke pasur parirjen për të qenë realistë edhe në lidhje me vështirësitë jo të vogla që do të hasë ky proces, synimi më i gjerë për grumbullimin e të dhënave për gjuhën e folur shqipe (dhe jo thjesht për mikrovariacionin sintaksor në të folme të ndryshme) do të ishte një proces përmes të cilit, me të njëjtat energji të shpenzuara, do të merreshin të dhëna që do të mundësonin shqyrtime të shumanshme gjuhësore; për më tepër, puna për krijimin e korpusit mund të fillohej menjëherë, mbi bazën e të dhënave të

¹⁰ Prej nocionit të *kompetencës gjuhësore*, në vitet 1980, nën ndikimin e etnografisë së komunikimit dhe të filozofisë së ligjërimin, është kaluar në nocionin e *kompetencës komunikative*, madje të *kompetencës diskursive a pragmatike*. Ndaj P. Charaudeau dallon ato katër tipa të kompetencës. Shih më gjerë, "Compétence discursive", në *Dictionnaire d'Analyse du Discours*, sous la direction de P. Charaudeau, D. Maingueneau, Editions du Seuil, 2002, f. 113-114.

grumbulluara tashmë. Kështu mund të shfrytëzohej qysh në një fazë të parë, të menjëhershme, gjithë ajo pasuri regjistrimesh që është bërë ndërkohë për shqipen; do të mund të shfrytëzoheshin po ashtu regjistrime të pranishme në arkivat e medieve audio-vizive (në ato hapësira ku e lejon legjislacioni në fuqi); do të mund të orientohej puna në vijim mbi synime konkrete e në përputhje me kriteret e sotme të shqyrtimit të gjuhës së folur, duke synuar grumbullimin e të dhënave në formë diskursesh e tekstesh të folura etj. Ndërkohë edhe nevojat për dëshmitë gjuhësore që do të mundësojnë shqyrtimin e variacionit sintaksor do të ishin të integruara në këtë proces, kupto në çdo rast edhe atë topolektal. Ndërkohë që përpunohen të dhënat që vijnë prej regjistrimeve tashmë të bëra, përgatitet edhe platforma më e detajuar e metodologjisë së regjistrimit dhe grumbullimit rishtas të të dhënave që i shërbejnë korpusit të gjuhës së folur dhe variantit të tij topolektal.

Në fakt, studimi i materialit të ofruar nga hartuesit e projektit, problemet interesante që parashtrihen nga vjeljet e kujdesshme të një literature të gjerë na e përforcojnë bindjen që krijimi i *korpusit të gjuhës së folur shqipe* do të krijojë një kontekst më të gjerë interpretimi për dukuritë e përqokura dhe do të mundësojë studimin e tyre në kuadër të mikrovariacionit sintaksor, por edhe përtej fjalisë (shumë prej dukurive e parakuptojnë ose e kanë të nevojshëm këtë interpretimin).

Në materialin e vjelë (e të paraqitur nga hartuesit e projektit) e parakuptojnë këtë status interpretimi: shembujt që bartin problemet që kanë të bëjnë me temporalitetin, aspektualitetin e modalitetin në të folmet e ndryshme të shqipes, te të cilët shfaqja e atyre kategorive mundësohet edhe nga prania e elementeve gjuhësore më periferike, që nuk kanë lidhje të ngushtë e të drejtpërdrejtë me bërthamën predikative në thënie; problemet që lidhen me vlerat kuptimore që folja bart në varësi të situatës së komunikimit e pozicionimeve konjitive të folësit në komunikim përmes referencialëve të ndryshëm diskursivë që përvijohen në thënie; problemet që kanë të bëjnë me shprehjen e mohimit në shqipe (mohimit të drejtpërdrejtë a alternativ); ato që kanë të bëjnë me klasën e lidhëzorëve (konektorëve) e në veçanti me lidhëzorët diskursivë, interpretimi i të cilëve kërkon kontekst më të gjerë se fjalia; problemet që lidhen me strukturat pyetëse (me bashkërenditje a nënrenditje), ku luajnë rol jo vetëm treguesit morfologjikë si mjete lidhëse, por edhe karakteristikat formale e semantiko-pragmatike të sifjalive të aktualizuara¹¹ të brendashkruara. Po ashtu problemet që shfaqen në analizë si pasojë e marrjes

¹¹ Me termin *sifjali e aktualizuar* shënjojmë njësinë minimale në analizën tekstore (të përdorur në vend të koncepteve *clause* dhe *proposition énoncée*); me këtë term parakuptojmë një akt enonciativ të natyrës sintagmatike ose të fjalisë së thjeshtë. Shih më gjerë, T. Plangarica, “Sërish mbi konceptet *fjali, periudhë, thënie, diskurs, tekst* në shkencat e ligjërimit”, në *Kërkime gjuhësore, VII*, ASA, Tiranë 2019, f. 189-203.

parasysh të thëniepërfutjesit në ligjërim, që nxit diskutime të shumta edhe për një mori dukurish që janë interpretuar thjesht në aspektin morfologjik a mikrosintaksor, që lidhen me përdorimin e trajtave të shkurtra e në veçanti me dhanoren (etike) në shqipe; problemet e përdorimit në të folme të ndryshme të vendores me parafjalë të rrjedhore + emër në kallëzore; problemet që lidhen me dyfishimin e kundrinës etj. etj.

Pra, pavarësisht nga synimi i orientuar kryesisht në studimin e variacionit sintaksor në të folmet e shqipes (përmes një qasjeje të natyrës dialektologjike), në fakt projekti bart vetvetishëm një problematikë më të gjerë, e cila të orienton natyrshëm në shqyrtimin e dukurive që lidhen me *gjuhën e folur* dhe variantet e pranishme në të. Për më tepër, duke parë më nga afër synimet e projektit, vështrimi drejtohet natyrshëm në situatën e sotme të gjuhës shqipe të folur. Madje në *Thirrje* (dokumenti që bashkëshoqëron shpalljen e projektit dhe fton studiuesit të angazhohen për realizimin e projektit) theksohet se si synim është “[...] të dokumentojë variacionin sintaksor në shqipen e sotme, duke përfshirë këtu *variacionin që lidhet me grupmosha e profesione të ndryshme ...*”; pra, në nivele jo thjesht dialektore, por edhe sociolinguistike: diatopike dhe diastratike.

Së fundi, mund të theksojmë se krijimi i *korpusit gjuhësor të gjuhës së folur*¹² ka marrë përparësi në strategjitë e zhvillimit të mendimit gjuhësor të sotëm, ngaqë *variacioni* në gjuhë është dukuri bashkëshoqëruese e vetë ekzistencës së gjuhës, e pandashme nga zhvillimi i saj; dhe forma e folur e gjuhës i shpreh më vetvetishëm e më natyrshëm prirjet që fitojnë shpërhapje më të gjerë përkrah atij evoluimi. Ndjekja sa më parë e kësaj prirjeje edhe nga mendimi ynë gjuhësor është veçse kohë e fituar. Por kjo kohë s’mund të fitohet pa shpenzimin paraprak të energjive për krijimin e kontekstit të duhur teorik në mendimin tonë gjuhësor dhe, mbi këtë bazë, përgatitjen e një platforme sa më të thukët për grumbullimin dhe shqyrtimin e të dhënave të atij korpusi.

¹² Korpusi gjuhësor i gjuhës së folur mendohet jo si një tërësi fjalësh e frazash të palidhura me një kontekst të caktuar, por si një tërësi tekstesh gojore të adresuara me synime të caktuara të folësit në komunikim dhe të ngjizura gjuhësisht në lidhje të ngushtë me situatën e komunikimit. Përmes programeve të ndryshme informatike bëhet trajtimi i të dhënave përmes transkriptimit prej specialistëve të regjistrimeve sonore. Teknologjitë e sotme ndihmojnë për përpunimin më të shpejtë e më të frytshëm. Përvijimi i një korpusi të gjuhës së folur “nuk parakupton thjesht sasi materiali të regjistruar, një koleksion të gjerë dëshmish gojore, por një objekt “të ndërtuar”, pra që i është nënshtruar përpunimit, trajtimit të të dhënave (numerizimit, transkriptimit, indeksimit) që mundësojnë jo vetëm t’i ruajmë ato të dhëna, por edhe t’u japim një status të ri, t’i shndërrojmë në lëndë për studim dhe vlerësim (*Corpus oraux, guide des bonnes pratiques 2006*, nën drejtimin e Oliver Baudet, CNRS Editions, Presses Universitaires Orléans, 2006, f. 11).

- *Ndërdisiplinariteti a shumëdisiplinariteti në shqyrtimin e të dhënave të Korpusit të gjuhës së folur*

Synimet ambicioze për përmbushjen e synimeve të këtyre dy projekteve të harmonizuar me njëri-tjetrin do të duhet të paraprihen nga zhvillimet e brendshme në vetë mendimin tonë gjuhësor, të paraprihen nga familjarizimi me konceptet, metodologjitë e parimet që janë përpunuar tashmë në disiplina të ndryshme të shkencave të ligjërimit. Do të duhet të zhvillojmë ato dije që mundësojnë krijimin e korpusit të gjuhës së folur; madje edhe ato dije që mundësojnë të shqyrtohet edhe vetë sintaksa dialektore, mikrovariacioni sintaksor në shqipen e folur.

Nga studiuesit pranohet tashmë që studimet e mbështetura në korpuset e gjuhëve të folura i kanë rinovuar tërësisht shkencat e ligjërimit. Janë formësuar ndërkohë në përbërje të disiplinave gjuhësore ekzistuese kahe studimi të cilat shqyrtojnë dukuri të veçanta që shfaqen përgjatë përdorimit të folur të gjuhës. Larmia e profileve që shfaq ky objekt kërkon po ashtu edhe qasje të larmishme që do t'i ndriçojnë ato profile.

Në fakt, epoka e tanishme, me parashtrimin e nevojave për shqyrtimin e aspekteve të ndryshme të realitetit gjuhësor të folur, mundëson njëherazi edhe një shumësi metodash, konceptesh e mbështetjeje teorike për studimin e dukurive, krahas lehtësisë së jashtëzakonshme që krijojnë teknologjitë e reja të regjistrimit e përpunimit të të dhënave. Zhvillimet e sotme në fushën e gjuhësisë dhe inxhinierisë gjuhësore nxitin prirjen drejt *ndërdisiplinaritetit* në shqyrtime, madje *shumëdisiplinaritetit* në studimin e gjuhës / ligjërimit.

Ky status i ri i dijes në këtë fushë përvijohet prej ndikimit të një morie arsyes: sepse pjesë e kontekstit epistemologjik janë bërë edhe të tjera kategori, si *të thënë* (*enonciacioni*), *subjekti*, *konteksti*, *situata komunikative* etj.; sepse kërkohej edhe të tjera *funksi*one që përmbushen përmes përdorimit të gjuhës, jo thjesht ai *paraqitës* a *informues*, por sidomos edhe *veprues*, *shndërrues*; sepse vetë objekti i studimit “gjuhë” vërehet në një shumësi profilesh (në të synohet të shqyrtohen jo thjesht njësitë e nënsistemeve të ndryshme nga *tingulli-fonemë* e deri te *ffjalja*, por edhe *produktet e përfuara në procesin e përdorimit* të atyre njërive, produkte të kushtëzuara më së tepërmi edhe nga faktorë jashtëgjuhësorë, kontekstualë, situativë, të cilët kushtëzojnë kuptimet e bartura dhe të përçuar); sepse vetë *gjuhësia* është integruar natyrshëm në një hapësirë më të gjerë shqyrtimeesh e bashkëlidhjesh, që mundësojnë shqyrtime të aspekteve të pashqyrtuara më parë; sepse epoka e sotme mundëson të fitojnë ekzistencë tejet të shfaqur e të mirëformësuar edhe ato veti të bartura potencialisht në ligjërim e të shfaqura si të tilla në një kohë të caktuar (një ndër këto veti bashkëshoqëruese të ekzistencës e zhvillimit të gjuhës është edhe *variacioni* në gjuhë).

Në rastin tonë, zgjerimi i përmasave të këtij konteksti epistemologjik nxitet natyrshëm nga vetë situata e sotme e shqipes së folur, ku dukuritë

shfaqen (e duhet të shqyrtohen) jo vetëm përmes qasjes *gjuhë e folur – dialekt* (duke parakuptuar në këtë rast variantin gjuhësor me përkatësi të caktuar hapësinore – në këndvështrimin diatopik), por edhe qasjes *gjuhë e folur – sociolekt e idiolekt* (duke parakuptuar në këtë rast varietetin a variantin gjuhësor me përkatësi të caktuar sociale – në këndvështrimin diastratik) apo qasjes *gjuhë e folur - situatë komunikative, thëniesore* (duke parakuptuar në këtë rast produktin gjuhësor me përkatësi të caktuar situative etj.), pra në këndvështrimin diafazik, stilistik e pragmatik. Ky kontekst epistemologjik na çon natyrshëm në hapësirat e një gjuhësie të re, që nuk është më ajo e gjuhës, por e ligjërimin, jo thjesht e njësisve sistemore, por e atyre përdorimore, te një gramatikë jo vetëm e rregullave, por edhe e opsioneve, te njësi jo vetëm të mbyllura, të kryera (fjalja), por edhe të hapura (diskursi, teksti). Ky kontekst më i gjerë epistemologjik na sugjeron po ashtu një rishikim a ritrajtim të metaligjërimin që lidhet me sistemin e koncepteve e terminologjinë përkatëse në shqyrtim; e më drejtpërdrejt akoma, në praninë e dy kaheve në shqyrtim: të mikrosintaksës e makrosintaksës /pragmasintaksës dhe koncepteve e njësisve të përvijuara tashmë në këto dy fusha studimi.¹³

Për këtë hapësirë të re shqyrtimesh, E. Benveniste, qysh më 1974 theksonte që fusha e analizës transfrastike / përtejfralore e teksteve do të kërkonte një “aparaturë të ri të koncepteve dhe të përkufizimeve”¹⁴; A. Culioli, nga ana e tij, theksonte se “[...] na duhet ta tejkalojmë frazën dhe ja, pra, të përfshihemi në të njëjtin nivel në diskurs, me paragrafin më së pari, dhe lidhjen e paragrafëve më tej, prej nga do të na përftohet një tipologji e diskurseve sipas mënyrave të vargëzimit dhe rregullave të koherencës”¹⁵.

¹³ Duke u mbështetur në përcaktime të ndryshme në lidhje me termat, mund të themi se *mikrosintaksa* vihet në shërbim të shqyrtimit të lidhjeve të varësisë, të kushtëzimeve “reksionale” që veprojnë përreth foljes, emrit dhe mbiemrit; ajo është fusha që tregon zakonisht vetë termi i sintaksës. *Makrosintaksa* do të shqyrtojë lidhjet që nuk mund të përshkruhen duke u nisur prej kushtëzimeve reksionale: ndajshimet, gjymtyrët e veçuara, të ndërallura etj., konfigurimet e vështira sintaksore që nuk mund të analizohen në kuadrin e një gramatike të thjeshtë përbërësish. Por termi ‘makrosintaksë’ është zgjeruar më tej, duke parakuptuar gjithashtu tërësinë e shenjuesve semantikë që përbëjnë arkitekturën tekstore ose edhe një formë shqyrtimi të strukturimit të ligjërimin, përtej një njësie morfosintaksore koherente. Dallimi mes mikro- e makrosintaksës ka lindur nga nevoja për të dalluar këto dy forma segmentimi, karakterizuese sidomos për ligjërimin e folur. (Shih Mathieu Avanzi, “Regards croisés sur la notion de macro-syntaxe”, në *Travaux neuchâtelois de linguistique*, 2007, f. 39.)

¹⁴ Emile Benveniste, *Problèmes de linguistique générale*, 2, Editions Gallimard, 1974, f. 65.

¹⁵ Antoine Culioli, “Linguistique du discours et discours sur la linguistique”, në *Revue philosophique*, n° 4, f. 473.

- *Dobia e krijimit të Korpusit të gjuhës së folur për nxitjen e zhvillimit të mendimit gjuhësor*

Korpusi i gjuhës së folur, i përvijuar sipas kriterëve bashkëkohore, do të ndihmojë më tej shqyrtime në disiplina të tilla si në atë të *psikolinguistikës* (edhe në kahe që shqyrtojnë produktet gjuhësore të folura, perceptimin e ligjërimit të folur dhe rolin e intuitës gjuhësore përgjatë procesit të të folurit), të *analizës së bashkëbisedimit*, të *analizës së ndërveprimeve* dhe kodeve të negocimit e politesës etj. E po ashtu do të jetë nxitje në fushën e *neurolinguistikës*, që do të mund të shqyrtojë të tjera procese të të folurit, siç janë ato që lidhen me praninë e pjesëzave të ndryshme diskursive, përsëritjet, mëdyshjet / hezitimet në të folur, rimarrjet a rregullimet gjuhësore etj., tejet karakterizuese të realitetit gjuhësor të folur.

Në mënyrë të veçantë, krijimi i këtij korpusi do të jetë nxitje për kahet e ndryshme të shqyrtimit në kuadër të *gjuhësisë së zbatuar*, duke sjellë prurje të vlefshme teorike e praktike në interpretimin e dukurive fonetike, leksikore, semantike, morfologjike e sintaksore (ndërkohë që aktualisht pjesë e interpretimeve në këtë disiplinë gjuhësore janë bërë edhe dukuri të tjera të natyrës pragmatike që shfaqen gjatë të folurit). Madje mund të bëhet nxitje edhe për përvijimin e *gjuhësisë së korpusit*, si pjesë përbërëse e problematikës së shqyrtuar nga gjuhësia e zbatuar, e cila, duke filluar nga vitet 1970, është përvijuar si dije gjithnjë e më sistemore. Gjuhësia e korpusit e vëren domethënien a kuptimin e përftuar në thënie a diskurs më shumë në ndërveprimin mes njerëzve sesa të përftuar në mendjen e folësve. Ajo i kushton në këtë mënyrë një rëndësi të dorës së parë kontekstit (e ko[n]tekstit gjuhësor) të përdorimit të njësie gjuhësore. Në studimet e ndërmarra në këtë lëmë studimi theksohet se “vetëm fjalët e marra në kontekst kanë kuptim dhe ajo çka ato duan të thonë është e përcaktuar nga përdorimet e tyre në kontekstet përkatëse. T’i japësh kuptim një segmenti tekstor do të thotë të shqyrtosh lidhjet ndërtekstore që e rilidhin atë me përmasën diakronike të diskursit. Hermeneutika vendoset pra si kuadri teorik i një gjuhësie të korpusit, e cila kërkon të vendosen urat e kalimit mes ligjërimit dhe shoqërisë”.¹⁶ Për studiuesit e kësaj disipline gjuhësore, thëniet tona janë shumë më pak rezultat i aftësisë krijuese gjuhësore të njeriut, sesa i përsëritjeve të vazhdueshme dhe variacioneve mbi formula të gatshme. Madje John McHardy Sinclair-i thekson se “kur flasim, nuk zgjedhim “një fjalë”, por një tërësi njësisish gjuhësore të parandërtuar”.¹⁷ Për Wolfgang Teubert-in, *njësitë a item-et leksikore*¹⁸ fitojnë

¹⁶ Wolfgang Teubert, “La linguistique de corpus : une alternative [version abrégée]”, *Sémen* [në linjë], 01 avril 2009.

¹⁷ Cituar nga E. Délais-Roussarie, “Linguistique de Corpus” në *Cours de linguistique théorique et descriptive*, [En ligne], konsultuar më 20 gusht 2018.

kuptim jo në mënyrë të izoluar, por vetëm të marra në kontekstin në të cilin përdoren. Kuptimi i tyre varet gjerësisht prej shfaqjeve të tyre në përdorim, prej njësisive përligjëse, gramatikore dhe leksikore që i rrethojnë. Ngjizja a përvijimi i kuptimit është rezultat i një renditjeje, i një vargëzimi fjalësh në një kontekst të caktuar që përsërit vargëzimet që janë formuar më parë, e më parë, në diskurs, dhe pra, në korpus”.¹⁹

Gjithashtu krijimi i korpusit të gjuhës së folur do të sjellë të dhëna me vlerë edhe për disiplinat gjuhësore që studiojnë sistemin gjuhësor, më drejtpërdrejt edhe për fushën e gramatikës. Më ngushtë akoma në atë të sintaksës. Në përvojat e ndryshme studimore europiane prania dhe larmia e të dhënave që ofron korpusi i gjuhës së folur ka mundësuar përvijimin e qasjeve të ndryshme të studimit, mënyra të tjera të segmentimit sintaksor të diskursit gojor, që integrohen në kuadër të modeleve të ndryshme të analizës makrosintaksore. Kështu, studiuesit e gjuhës së folur i kushtojnë vëmendje të veçantë një varësie të dytë sintaksore që përftohet prej kombinimeve morfosintaksore, të cilat realizojnë kohezionin e produkteve më të gjata gojore (por edhe të shkruara), në të cilat shumë “plotësa” a “sifjali” nuk drejtohen prej foljeve, por nga tërësia e ndërtimit verbal dhe situata diskursive (dhe në këtë rast, në përftimin e njësisive makrosintaksore rol të rëndësishëm luan edhe intonacioni). Qoftë të ashtuquajturat modele shtresëzuese, që i konsiderojnë njësitë maksimale të mikrosintaksës (*sifjalitë e aktualizuara* a *clause-at* për Berrendonner-in) si njësi bazë për njësitë më të mëdha në makrosintaksë, qoftë të ashtuquajturat modele modulare, që i konsiderojnë të dy tipat e organizimit sintaksor në mikrosintaksë e makrosintaksë si të pavarura (për shembull, modeli i përpunuar për gjuhën frënge të folur nga ekipi i gjuhëtarëve të shkollës Aix-en-Provence ose, për gjuhën italiane, modeli i përpunuar nga gjuhëtarja Emanuela Cresti), apo përpjekje të tjera në këtë aspekt, në thelb pranojnë nevojën e shqyrtimit të dukurive në diskurs përmes parametrave e kritereve që shkojnë përtej atyre të përvijuar nga sintaksa e fjalisë (mikrosintaksa). Qasjet e reja në shqyrtim kanë mundësuar përcaktimin e njësisive të tjera që bëhen bazë për segmentimin sintaksor, qoftë duke

¹⁸ W. Teubert-i përdor termin “*item* leksikor” dhe jo “fjalë”. Një *item* leksikor është njësi kuptimi, është një monosemë që e fiton kuptimin përgjatë përdorimit dhe në kontekstin përkatës. Sipas tij, “*item-et* leksikore shfaqen si një a shumë fjalë, madje edhe si një fjali e tërë, në rastin e disa idiomave”. Autori ilustron me togun “botë e qytetëruar”, i cili nuk mund të reduktohet në kuptimet përkatëse të “botë” dhe “e qytetëruar”. Si *item* leksikor ky grup fjalësh shërben për të shenjuar “ne”, që dallohen prej “atyre” në kontekstin që përdoret në media sot. Sintagma tregon për “ne”, që kemi një status më të lartë se statusi që u jepet “atyre”, edhe pse “ata” në një aspekt formal mund të udhëhiqen nga po të njëjtat ligjësi të një shoqërie të qytetëruar. (Teubert, 2009, art. i cit.)

¹⁹ Wolfgang Teubert, art. i cit.

ripërcaktuar a rikuptimësuar njësitë me të cilat ka shqyrtuar edhe më parë tradita gramatikore (njësi të tilla si *clause, frazë, periudhë, sekuencë* etj.), qoftë përmes rikonsiderimit të tyre si *njësi reksionale* (në nivelin e mikrosintaksës) dhe *ilokutive* (në nivelin e makrosintaksës).²⁰

Është e nevojshme të familjarizohemi edhe me këto qasje teorike e t'i përdorim përvojat e këtyre shkollave gjuhësore në dobi të krijimit e studimit të korpusit gjuhësor të folur të shqipes.

- *Një traditë e përvijuar që mund të evoluojë*

Deri tani, shqyrtimet gjuhësore, në shumicën e rasteve, janë bërë duke u mbështetur kryesisht në gjuhën e shkruar, duke marrë si model ligjërimin letrar në veprat letrare. Ky ligjërim është i normëzuar, edhe pse të shprehurit e personazheve (në rastin e prozës a dramatikës) shfaq jo pak tipare të veçanta të gjuhës së folur. Gjithsesi, larmia ligjërimore që shfaqet nga gjuha / ligjërimi i personazheve nuk është e mjaftueshme për të gjykuar për pasurinë e larminë e shqipes së folur; për më tepër, ligjërimi i personazheve kalon nëpër filtrin e kompetencës ligjërimore të vetë shkrimtarit dhe i përshtatet ligjërimin në gjuhën e shkruar. Krijimi i korpusit të gjuhës së folur mundëson kontaktin me format, organizimet e përdorimet e gjalla të shqipes, përtej këtyre filtrave. “Kujdesi ndaj produktit gojor, – thekson Blanche-Benveniste, – ka mundësuar zhvendosjen e vëzhgimit drejt aktiviteteve ligjërimore më pak konformiste se ato të të shkruarit dhe më pranë një lloj “gjendjeje të egër” të shprehjes”.²¹ Njohja edhe e kësaj “gjendjeje të egër” të shprehjes do të ndikojë që të evoluojnë edhe konceptet teorike mbi të cilat ngjizen përvoja të ndryshme shqyrtimi (po ashtu të evoluojnë edhe praktikatat për regjistrimin e më tej shqyrtimin e dëshmimeve gjuhësore të grumbulluara). Përftohet në këtë mënyrë një tërësi të dhënash që mund të ndriçohen nga një metodologji e re në

²⁰ *Njësitë reksionale* janë njësitë e shqyrtimit në plan mikrosintaksor, të përfuara si pasojë e kohezionit të brendshëm që përftohet përmes lidhjeve të varësisë dhe grumbullimit / pranëvënies të elementeve gjuhësore në formën e një peme varësie elementesh, ku përreth një koke, që nuk është e varur në aspektin sintaksor prej asnjë elementi të rendit më të lartë, varet një tërësi elementesh. *Njësitë ilokutive* janë njësitë e shqyrtimit në plan makrosintaksor të diskursit, kohezioni brenda të cilave sigurohet nga lidhje që shkojnë përtej varësisë sintaksore. Njësia ilokutive konsiderohet si njësia maksimale e makrosintaksës që parakupton praninë e një akti ilokutiv në diskurs, pra, një tërësi segmentesh që kontribuojnë për të realizuar një pohim, një pyetje, një urdhër etj. Njësitë ilokutive analizohen përmes një numri njësisish përbërëse që janë përbërësit ilokutivë (mbështetur në Paola Pietrandrea, “Constructions grammaticales et discours”, Mémoire présenté en vue d’obtenir une Habilitation à Diriger des Recherches, 2010, en ligne, version 1, 28 janvier 2012, f. 119.

²¹ Claire Blanche-Benveniste “Un modèle d’analyse syntaxique ‘en grilles’ pour les productions orales”, në Anuario de Psicología, 1990, n° 47, f. 11-28, këtu f. 12.

shqyrtim dhe kritere më të përshtatshme interpretimi për natyrën e objektit “të ndërtuar”; e për pasojë, edhe qëndrime të reja që shohin në mënyrë kritike edhe interpretimet e traditës gramatikore. Madje edhe njërin prej këtyre aspekteve, që ka të bëjë me qasjen ndaj gjuhës së normëzuar: ky qëndrim mbështetet në një sistem disi rrethor, të mbyllur, në të cilin *gramatika përshkruan gjuhën e normëzuar – gjuha e normëzuar respekton kuadrin e përcaktuar nga gramatika*. Çdo fakt që del prej këtij kuadri do të parakuptohet në mënyrë negative. Kështu, për një thënie që gramatika nuk mund ta përshkruajë, priremi ta konsiderojmë, në rastin më të mirë, si të keqndërtuar dhe, në rastin më të keq, si jogramatikore, jashtë sintaksës. Krijimi i korpusit të gjuhës së folur dhe rastet e përdorimeve të pranishme në të mund të na krijojnë një pamje më të plotë për statusin real të përdorimeve në gjuhë, edhe të strukturave sintaksore, të cilat formësohen e përshtaten me situatat e komunikimit, regjistrat e ndryshëm gjuhësorë etj.

Madje, në kontekstin e studimeve tona, jemi në kohë që të hedhim bazat e të zhvillojmë edhe për shqipen të ashtuquajturën disiplinë të “gjuhësisë së korpusit” me të gjitha kahet e shfaqjes e të ekzistencës së saj. E në këtë mënyrë, të nxisim më tej shqyrtimet në problematika të tilla, si roli i kontekstit në përvijimin e thënieve dhe të prozodisë në përvijimin e teksteve të folura, të kushtëzimit të ligjërimit formal dhe informal, në varësi të situatave ligjërimore, të natyrës së lidhjeve mes sintaksës dhe situatave të të folurit, etj.

Jemi në kohë, gjithashtu, për të gjallëruar përvojat e organizimit të “diskutimeve shkencore a seminareve”, pranë Institutit të Gjuhësisë, ku të zgjerohet pjesëmarrja me pedagogë të universiteteve tona që mund të angazhohen për këto projekte dhe të trajtohen tema që mund të nxisin reflektimet në lidhje me objektin e projekteve. Do të ishte nismë e mbarë diskutimi në lidhje me tema të tilla, si: Roli i gjuhës së folur për reflektime të mëtejshme gjuhësore; Gjuhësia e korpusit, mikrosintaksa e makrosintaksa; Rishqyrtime të statusit të njësive të tilla si propozicioni, fjalia / fraza, thënia, mikropërftesa ligjërimore, diskursi, teksti; Temporaliteti, aspektualiteti dhe modaliteti në shqipen e sotme dhe vështrimet kognitive të tij; Njësitë diskursive / aktet e të folurit dhe roli i konektorëve, deiktikëve, njësive modale etj.; Informatika në ndihmë të shqyrtimit të korpusit të të dhënave gjuhësore; Përvoja të formësimit të korpusit gjuhësor të gjuhës së folur në Itali, Portugali, Spanjë, Gjermani, Angli, Francë etj.

E mbi këtë bazë të mund të organizoheshin më tej tryeza të rumbullakëta edhe me doktorantë e mësues të gjuhës shqipe ku mund të diskutohet për një platformë të detajuar për metodologjinë e grumbullimit të të dhënave dhe regjistrimit të tyre, një proces që parakupton anën konceptuale të punës dhe atë të realizimit të saj praktik.

Edhe pse në pamje të parë duket se vështirësia qëndron në punën në terren, në regjistrimin e të dhënave për krijimin e korpusit (duke mos e lënë mënjanë

këtë vështirësi), na duket se punë gjithashtu e vështirë është shqyrtimi i të dhënave nga specialistët, sepse tek ata duhet përftuar konteksti teorik i shqyrtimeve, sistemi i dijeve aktuale gjuhësore për këtë gjuhësi të re dhe i koncepteve përkatëse shqyrtuese. Për më tepër, përvijimi i korpusit të të dhënave do të jetë i vlefshëm, në një masë të madhe, nëse vjeljet do të bëhen pasi specialistët të kenë qartësuar problematikën e dukuritë që duhet të studiojnë, në mënyrë që vetë ata apo të tjerët të trajnuar prej tyre, të krijojnë mundësinë që situatat komunikative përgjatë vjeljes a regjistrimit të materialit të synojnë në mënyrë të ndryshme daljen në pah të dukurive që janë parashikuar edhe teorikisht nga specialistët. Ndaj projektet kërkojnë bashkëpunim të ngushtë mes ekipeve të specialistëve, të profesorëve, doktorantëve, mësuesve të gjuhës shqipe etj.

Përvojat që vijnë nga vende të ndryshme dhe programet e softuerët (mjetet programuese) që përdoren për përpunimin e të dhënave janë një ndihmë konkrete për punën që do të ndërmerret, por duhet përvetësuar ndërkohë baza teorike mbi të cilën janë ngjizur ato përvoja dhe aftësimi për të përdorur teknologjitë e reja në regjistrim e sidomos në përpunimin e të dhënave.

- *Në mbyllje*

Ngulmojmë në rëndësinë e krijimit të korpusit të gjuhës së folur shqipe, sepse “të arrish përfitim e korpuseve gojore, do të thotë të mundësosh hapa të tjerë drejt njohjes së trashëgimisë gjuhësore, të japësh një mjet të çmuar për njohjen e praktikave ligjërimore të nevojshme për përcaktimin e politikave gjuhësore, por edhe politikave sociale e të edukimit”.²² Të folurit, ligjërimi ynë, diskursi ynë, është pjesë e identitetit tonë, e veçantisë sonë kulturore. Le të kujtojmë në këtë rast se treguesit tanë kulturorë nuk janë të ngjizur në fjalë a rregulla gjuhësore, por në mënyrat tona të të shprehurit, në veçantitë e të rrëfyerit a të argumentuarit, të shpjeguarit a të përshkruarit, të qasjes sonë estetike ndaj pasqyrimit të asaj çka na rrethon dhe asaj çka duam të transmetojmë. Janë këto veçanti që na identifikojnë si komunitet.

Përveç të tjerave, krijimi i korpusit të gjuhës së folur e shqyrtimi i tij është një mundësi më shumë për ta ndriçuar këtë identitet e për të reflektuar në lidhje me të.

²² *Corpus oraux, guide des bonnes pratiques 2006*, nën drejtimin e Oliver Baudet, CNRS Editions, Presses Universitaires Orléans, 2006, f. 11.

SUMMARY

THE STUDY OF DIALECTICAL SYNTAX AND THE CORPUS OF SPOKEN ALBANIAN

This paper points out the significance of the project “The Syntactic variation in Albanian” and the preparation of a Syntactic atlas of Albanian dialects, and at the same time contends that it might/should widen in extent by seeking to create the corpus of spoken Albanian. In accordance with the findings of various European projects which have examined peculiarities of the spoken language focusing on the spoken languages’ corpuses in respective countries, we maintain that widening the project goals’ extent is useful and ensures the fulfillment of both aims. In addition, the paper pinpoints worthy approaches/ways in the micro and macro-syntactic level which will be of great benefit in the study of Albanian as well. The development of Albanian linguistic thought will naturally enter a new stage due to the work for the creation of the corpus of spoken Albanian and in focus will obviously be not only the examination of the Albanian system’s units, but also the phenomena of a discursive nature, thus stimulating more systematic studies in various scholarly disciplines of the discursive sciences.

